

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN MARKAT, SARANDË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Markat, Sarandë, , me objekt: ““Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit,lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë komunale, etj.”dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.15 , datë 06. 02.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 380/6, datë 06.02.2012, dërguar z. **Ismail Murtaj**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Shpenzimet operative të programohen të argumentuara dhe të analizuara duke synuar uljen e tyre, me qëllim që këto fonde të orientohen në përdorimin e tyre për investime.

**-Vazhdimisht**

2. Në programimin e shpenzimeve për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla të mbahet parasysh kufiri monetar për artikuj dhe grup asortimentesh me qëllim përdorimin e fondeve pa i copëzuar ato dhe shmangien e procedurave ligjore të prokurimit, si në rastet e evidentuara gjatë periudhës së kontrolluar.

**-Vazhdimisht**

3. Me mbylljen e bilancit kontabël vjetor 2011, nga zyra e financës, sipas dispozitave ligjore, të kryhen sistemimet dhe të pasqyrohen në kontabilitet sipas analizave vlera reale e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e qarkulluese sipas inventarëve .

**-Menjëherë**

4. Nga zyra e taksave vendore mbi bazën e evidentimit të saktë të numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e komunës, kontrollit të xhiros së deklaruar dhe të realizuar në fakt të bëhet një programim sa më real për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe familjarët.

**- Menjëherë**

5. Nga Zyra e Tatim Taksave Vendore, të krijohen kartelat analitike për subjektet me të dhëna të plota me detyrimet dhe arkëtimet përkatëse, për ndjekjen dhe arkëtimin e tarifave dhe taksave vendore, dhe në fund të periudhës raportuese të rakordohet me zyrën e financës për regjistrimin e tyre në kontabilitet.

**-Vazhdimisht**

6. Të kontabilizohen dhe të arkëtohen detyrimet debitore për vitet 2009 e 2010, në vlerën 1.652.000 lekë sipas pasqyraës bashkëngjitur raportit përfundimtar të kontrollit.

**-Menjëherë**

7. Të merren masa për evidentimin e saktë të hapësirave publike të zëna , të rregjistrohen në kartelat dhe regjistrin përkatës për planifikimin dhe mbledhjen reale të taksave vendore.

**-Menjëherë**

8. Të merren masa për kryerjen e inventarit të tokës bujqësore, të inventarit të aseteve dhe atë ekonomik vjetor.

**-Menjëherë**

9. Të saktësohet numuri i familjarëve dhe i subjekteve fizik e juridik, të kompletohet dokumentacioni ligjor i rakorduar me ZVRPP Sarandë, për pasuritë që disponohen dhe sipërfaqet respektive mbi të cilat aplikohet taksa mbi pasuritë.

**Brenda datës 31.12.2012**

10. Të merren masa të menjëhershme nga Komuna, për krijimin e zyrës së aseteve e cila të kryej inventarizimin, vlerësimin, marrjen në dorëzim të pronave dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin.

**-Menjëherë**

11. Të merren masa nga Komuna, për krijimin e zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës, sipas ligjit nr. 8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” dhe të VKM nr. 532 , datë 31.10.2002, “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qark dhe zyrat e menaxhimit e mbrojtjes së tokës në komunë dhe /ose bashki”.

**-Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohet në rrugë ligjore vlera prej **774,498 lekë** e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të komunës nga 4 subjekte , si më poshtë:

1-Vlera prej 289,150 lekë, nga sipërmarrësi [REDAKTUAR] për objektin “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare, “Rait Bajo”, Shalës, Markat” pasi u konstatuan zëra të punimeve të pakryera, trajtuar në raportin përfundimtar në kapitullin e prokurimeve, në zbatimin e kontratave publike.

**-Menjëherë**

2-Vlera prej 337,600 lekë, nga sipërmarrësi “Arti” Shpk, për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Markat” pasi u konstatuan zëra të punimeve të pakryera, trajtuar në raportin përfundimtar në kapitullin e prokurimeve, në zbatimin e kontratave publike.

**-Menjëherë**

3- **Vlera prej 97,288 lekë**, nga sipërmarrësi [REDAKTUAR], për objektin “Ndertim ura metalike ne perruan e Frashkut” fshati Janjar i kësaj komune pasi u konstatuan zëra të punimeve të pakryera, trajtuar në raportin përfundimtar në kapitullin e prokurimeve, në zbatimin e kontratave publike.

**-Menjëherë**

4- Vlera prej 50,000 lekë, nga sipërmarrësi [REDAKTUAR], për objektin “Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm të ujsjellësit të fshatit Shalës” fshati Shalës i kësaj komune pasi u konstatuan zëra të punimeve të pakryera, trajtuar në raportin përfundimtar në kapitullin e prokurimeve, në zbatimin e kontratave publike.

**-Menjëherë**

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, Hekuarn Avdulaj dhe Ervehe Cumani. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**